



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Municipal Istog
Municipal Istog

Drejtoria për Arsim

05.Nr.386/18

Datë: 06.09.2018

Drejtoria për Arsim në Komunën e Istogut dukë u bazuar në neni 8 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nenit 35 të Ligjit Nr.04/L-032 Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligjit Nr.03/L-068 Për Arsim në Komunat e Republikës së Kosovës, dhe në mbështetje të: UA-MPMS, Nr.07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, UA-MASHT, nr.10/2018 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, UA-(Masht) Nr.05/2015 Normativi për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional si dhe UA-MASHT, nr.02/2017 Për Vlefshmerinë e Programeve Studimore të Bartësve Privat të Arsimit të Lartë, shpall këtë:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për mësimdhënës/e, viti shkollor 2018/2019

Gjimnazi "Haxhi Zeka" Istog

1. Një mësimdhënës/e për psikologji zëvendësim deri sa puntorja të kthehet nga pushimi i lehonis

Shmt "Mithat Frasheri" Gurrakoc

2. Dy mësimdhënës/e për drejtimin e infermiris (Mjekë Specialist ose Mjekë i Përgjithshëm) nga gjysem norme.

Shfmu "Bajram Curri" Istog

1. Një mësimdhënës/e për gjuhë Gjermane më mundësi të plotsimit të normës në shkollat tjera.

Shfmu "Hysni Zajmi" Vrellë

Një punëtor Rojë Natë vendi i lirë.

Vrejtje: kandidatët të cilët nuk e kalojnë pragun prej 50% të pikëve nga testi më shkrim nuk do të ftohen në Intervistë.

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurim:

- Formulari i aplikimit (kërkesa) të cilin e plotëson kandidati,
- Rezymeja personale (CV),
- Dokumenti personal (kopja e letërnjoftimit),
- Çertifikata e lindjes
- Kopja e diplomës e vërtetuar, ose certifikata në vend të diplomës e vërtetuar jo me e vjeter së gjashtë muaj gjdo certifikat me e vjeter së gjashtë muaj nga data e diplomimit nuk do të merret parasyshë.
- Kandidatët të cilët kanë diplomuar jashtë Republikës së Kosovës, duhet ti kenë diplomat e nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë,
- Dëshmitë e rikualifikimeve dhe trajnimeve të akredituara nga MASHT (nëse ka)
- Dëshmia që nuk jeni nën hetime ,
- Dëshmia e përvojës së punës në arsim (nëse ka)

Afati i konkursit mbetet i hapur prej datës 06.09.2018 deri më datën 14.09.2018.

Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbime me Qytetarë, në hyrje të ndërtesës së Komunës, zyra Nr.100,kati përdhësë dhe dorëzohet i plotësuar së bashku me dokumentacionin përcjellës po në të njëjten zyre.

Dokumentacioni duhet të jetë në kopje,Komisioni i pranimit në rast dyshimi do të kërkon origjinalin në intervistë. Ky dokumentacion shërben deri në përfundim të procedurës së konkursit i njejt nuk kthehet dhe as nuk ruhet. Dokumentacioni i pa kompletuar dhe ai i cili arrinë pas afatit nuk do të shqyrtohet gjithashtu kandidatët të cilët nuk e plotësojnë qartë dhe saktë formularin e aplikimit(kërkesën) do të refuzohet.

Në testin me shkrim dhe intervistë do të ftohen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriterët bazuar në aktet normative dhe legjislacionin në fuqi.

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të udhëzimit administrativ të MASHT-Nr.10/2018.Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm dhe UA nr.05/2015

Gjatë përzgjedhjes,në kushte të barabarta, përparësi do të kenë ata mësimdhënës që pa fajin e tyre kanë mbet pa vendë pune në ndonjërin nga shkollat e komunës së Istogut duke patur gjithmonë parasysh kriterin e përgatitjes profesionale.

Drejtori i DKA-së
Hajrush Shoshi

